Përgjaket Velipoja, xhaxha e nip sulmojnë me armë dy vëllezër

Publikuar më **20.05.2017** nga **Jola Alimemaj**

Nga Anila Dushi

Dy vëllezër kanë mbetur të plagosur në Velipojë pas një konflikti me disa persona të tjerë. Ervin dhe Durim Tahiri janë përleshur me persona të jerm dhe më pas kanë mbetur të plagosur rëndë. Fillimisht policia ka pretenduar se bëhet fjalë për një atentat por më pas është mësuar se gjithçka ka ndodhur për shkak të një sherri të ndodhur një ditë më parë me protagonistë të rinj të tjerë.

Sipas të dhënave që vijnë nga Shkodra bëhet me dije se vëllai i vogël i dy të plagosurve është konfliktuar me një djalë të fsit Ndoj e për pasojë palët e kanë lënë që ditën e djeshme të merreshin vesh por më pas ngjarja ka degraduar në përdorim armësh dhe në plagosjen e dy djemve Tahiri!

Policia ka marrë të dhënat e para dhe menjëherë mësohet se ka kryer ndalimin e Besnik Ndojt dhe ka shpallur në kërkim nipin e tij Aurel Ndojn. Dyshohet se ka qenë pikërisht Aureli që ka personi që ka qëlluar mbi dy vëllezërit Tahiri.

Policia

Dy shtetas kane mbetur të plagosur në Velipojë pas një sherri mes disa personave. Vëllezërit Ervin dhe Durim Tahiri 30 dhe 27 vjeç janë plagosur me armë zjarri automatik në qendër të Velipojës përballë njësisë administrative. Autorët e dyshuar janë persona nga fisi Ndoj, apo Përgega siç njihen në zonë. Vëllai i vogël i Ervin dhe Durim Tahirit është ngatërruar një ditë më parë në shkollën e mesme të Velipojës me një prej djemve të fisit Ndoj. Ngjarja ka precipituar edhe gjatë ditës së sotme me 19 maj kur rreth orës 12:50 të dy palët janë përleshur mes tyre. Disa persona të fisit Ndoj janë konfliktuar fizikisht me dy vëllezërit Tahiri.

Këto të fundit, sipas burimeve policore, kanë pasur edhe një automatik kallashnikov me vete por gjatë përleshjes pala tjetër e fsit Ndoj kane arritur që t'i rrëmbejnë automatikun dhe me pas të qëllojnë ndaj dy vëllezërve duke i lënë të plagosur.

Arrestimi

Ervin Tahiri është në gjendje të rëndë shëndetësore sepse është plagosur në kraharor ndërsa Durim Tahiri ka plumb në gjurin e tij. Policia ka ndaluar shtetasin Besnik Ndoj që dyshohet si autor i plagosjes se dyfishtë ndërsa është shpallur në kërkim edhe Aurel Ndoj, nipi i Besnikut.

Policia ka shoqëruar edhe shtetasin Gjovalin Ndoj, vëllai i Besnikut sepse edhe ai dyshohet se është përfshirë në këtë ngjarje. Shtetasi Besnik Ndoj është ndaluar bashkë me automatikun me te cilin dyshohet se ka kryer plagosjen. Policia po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe arrestimin e të gjithë personave të përfshirë në këtë sherr që çoi në plagosjen e dy vëllezërve Tahiri.

Për t'u bërë pjesë e grupit të "**Shekulli**"
mjafton të klikoni: **Join our FB Group** dhe kërkesa do t'ju aprovohet.

KOMUNITETI SHEKULLI ONLINE: https://www.facebook.com/groups/1381242728701899/

Comment

Name * Email *

Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

Post Comment

PD e Rilindja, larg duart nga zgjedhjet. Komisionet të jenë apartiake

Publikuar më 24.09.2017

Nga Erneta Shevroja Kryetarët e partive opozitare zhvilluan një takim për rreth dy orë në Tiranë, për rëndësinë e reformës zgjedhore dhe ndryshimet që pritet në ndodhin në ligjin zgjedhor, ku arritën në disa konkluzione të përbashkëta. Në një njoftim të frontit të bashkuar të partive opozitare, u deklarua se reforma zgjedhore është e pakthyeshme, […]

Lexo më shumë

Njerëz në bagazhe makinash, 21 vjet burg bandës shqiptaro-angleze

Publikuar më 20.09.2017

Nikoleta Kovaçi Një bandë kriminelësh, të cilët u përpoqën të trafikonin shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar u shpallën fajtor nga gjykata dhe u dënuan. Vendimi u dha dy ditë më parë ndërsa që në korrikun e këtij viti u lajmëruan nga ana e gjykatës se do të përfundohej gjithë gjyqi deri me 18 shtator. E […]

Lexo më shumë

Ruçi, kryetar i Kuvendit, ekspertja: Po përsëritet e kaluara!

Publikuar më 19.09.2017

Lori Amy, profesore në Universitetin Jugor të Xhorxhias, thotë për Zërin e Amerikës se krimet që shkaktoi komunizmi nuk mund të harrohen, por çështja është se si duhet kujtuar kjo e kaluar, në mënyrë që shoqëria të mos mbetet tek akuzat dhe viktimizimi. Profesoreja, e cila viziton shpesh Shqipërinë, po merret me studimin e traumave […]

Lexo më shumë

Trashëgimtari i Prek Cali: Shembja e paautorizuar

Publikuar më 17.09.2017

Nga Anila Dushi Pas debateve të përhapura së shumti në media në lidhje me kullën e shembur në Malësinë e madhe, ka reagualr edhe nipi i Prek Calit, heroit antikomunist të Shkodrës, i cili në fjalën e tij thotë se Kulla ishte shembur tërësisht nga persona të paautorizuar dhe kishte filluar ndërtimi i një objekti […]

Lexo më shumë

Ish-kreu i SHISH: Kodheli vodhi paratë dhe cënoi sigurinë Kombëtare

Publikuar më 17.09.2017

Ish-kreu i Shërbimit Informativ usht arak, Ylli Zyla, ka drejtuar akuza të rënda ndaj ish-ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, lidhur me mosfunksionimin e radarëve në det për kaqejen e skafeve me drogë. "Çako ka të drejtë kur thotë se sistemi i radarëve nuk po funksionon si duhet. Problemet kanë nisur në vitin 2015, kur sistemi […]

Lexo më shumë

Përgjimet fundosin dy transportuesit e minave me sahat, gjykata i lë në burg

Publikuar më 17.09.2017

Nga Xhentila Gjoshi Përgjimet ambientale janë pro va më e fortë e Prokurorisë së Tiranës, ndaj dy të rinjve Jurgen Muho dhe Eraldo Ka troshi, të cilët u kapën me tre mina me telekomandë. Ditën e djeshme, 24-vjeçari dhe 19-vjeçari dolën para Gjykatës së Tiranës, ku iu caktua masa e sigurisë "Arrest me burg". Gjykata […]

Lexo më shumë

SHBA, Ultimatum ndaj Koresë së Veriut: Ndalo menjëherë

Publikuar më 17.09.2017

Këshilli i Sigurimit në Kombet e Bashkuara dënoi fort lëshimin e raketës së fundit nga ana e Koresë së Veriut, duke i bërë thirrje vendit komunist të ndalojë menjëherë. 15 vendet anëtarë mbajtën një mbledhje të jashtëzakonshme me dyer të mbyllura, pas kërcënimit nga Peniani, që lëshoi raketën balistike e cila kaloi sërish mbi Japoni […]

Lexo më shumë

"Qeveria nuk përmbushi detyrimet e NATO-s, buxheti nën 1%"

Publikuar më 17.09.2017

Deklarata e kryeministrit Edi Rama se Shqipëria do të modernizojë forcën e saj ushtarake në takimin që Shtabet e Përgjithshëm të vendeve anëtare të NATO po zhvillojnë në Tiranë, ka shkaktuar dhe përplasje mes tij dhe kryetarit të Partisë Demokratike. Në mbledhjen e kreréve të krerëve të Shtabeve të Përgjithshme ku diskutohet mbi një seri […]

Lexo më shumë

LEXO TË TJERA

Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Kati 1, 1001, Tiranë, Shqipëri

Redaksia:
(+355) 69 20 46 662
info@shekulli.com.al

Marketing:
(+355) 69 20 46 662
reklama@shekulli.com.al

Politikat e privatësisë

"Shekulli Group"

SHEKULLI © 2020 / Websites in Albania by Tok Digital Agency